



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P.nr 329/16**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË** D.P. gjyqtari Ahmet Rexhaj me sekretaren juridike Lindmire Begolli ,në lëndën penale kundër të pandehurit T R nga R K. Kline , e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë -Departamenti i Përgjithshëm PP-II- 1431/2015 te dt. 14.04.2016 për vepër penale , rrezikimi I trafikut publik nga neni 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 3 te KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar ,publik dhe me gojë te mbajtur në praninë e të pandehurit T R dhe të Prokurori shtetit Ardian Hajdaraj , ne mungesë te palës se dëmtuar dhe përfaqësuesit te palës se dëmtuar me dt. 17.10.2017 , ka marrë dhe botërisht ka shpallë kurse me dt. 06.11.2017 muar këtë :

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri T. R i lindur me ..... ne f R K.K ku dhe tani jeton ne f. R K. Kline , i biri i K dhe nga nena D e gjinisë K , kam te kryer shkollën ....., shtetas i Republikës së Kosovës , mbrohet ne liri ,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për arsye se:**

Me dt. Me dt. 25.07.2015 rreth orës 13:15 min. ne f. J e Le shanit K. Pejë , nga pakujdesia ka shkelur neni 42 par 1 dhe nenin 71 par 1 te Ligjit mbi Sigurinë e komunikacionit rrugor te Kosovës , qe ka rezultuar me vdekjen e tani te ndjerit H ( V ) B , si dhe me lëndime te lehta trupore për te dëmtuarin R B nga f .LL K. M , ne atë mënyrë qe ne momentin gjersa ishin duke e drejtuar automjetin e tij te llojit ....” me ngjyre te verdhe me targa regj-..... ne aksin rrugor Peje – Prishtine sapo ka arritur ne vendin e lartcekur nuk ka qene i kujdesshem ne veprimet e veta m duke hyre ne tejkalim te pasigurte dhe duke i penguar lëvizjen e ngasësit te automjetit te llojit .... -... me targa regj ..... të cilin e drejtonte i dëmtuari R B ,me çrrastë me pjesën e pare ballore te automjetit perplase4et ne automjetin e te dëmtuarit , e ku si pasoje e lëndimeve te pësuar viktima H B ka vdekur ne QKU ne Prishtine me dt. 26.07.2015 rreth orës 10.00 gjersa i

dëmtuarit R ,për shkak te dëmtimeve trupore është trajtuar ne Spitalin regjionale ne Peje e po ashtu janë shkaktuar dëme materiale.

-me çka ka kryer vepre penale : rrezikimi I trafikut publik nga neni 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 3 te KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 43,45, 46,47 dhe nenit 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 3 të KPRK-së.

### DENIM ME BURG

Te pandehurit T. R i shqipton dënim me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte ) muajve e te cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit , -me pëlqimin e te pandehurit dënim me burg është zëvendësuar me dënim gjobe ne lartësi prej tremijë ( 3000) euro e te cilin është i obliguar qe ta paguaj ne afatin prej 3 muajve , pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Te pandehurit konform nenit 62 par 1 dhe 2 pika 2.4 dhe 2.5 dhe nenit 67 dhe 68 te KPPK-së te pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues marrja e patentë shofer si dhe ndalimi i drejtimit te automjetit ne kohëzgjatje prej 3 vjet

I pandehuri obligohet që në emër shpenzimeve procedurale te paguaj shume prej njëqinde (100) euro si dhe paushallit gjyqësore te paguaj shumen prej njëzet (20) euro ne afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridikë udhëzohet ne kontest civil

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Peje ,Departamenti për krime të Përgjithshme ka ngritur aktakuzë PP/II nr 1431/15 të dt. 14.04.2016 kundër të pandehurit T. R nga f. R K. Kline , për shkak te veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 9 lidhur me par 1 dhe 3 te KPRK-së ,

Me date 17.10.2017 është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar , dhe bazuar në dispoziten

e nenit 244 te KPP-së është konstatuar se prokurori i shtetit i ka përmbushur detyrimet qe kane të bëjnë me zbulimin e provave.

Gjykata komform dispozitave te nenit 246 par l. te KPP-së e ka udhëzuar të pandehurin me te drejtat e tij , i cili ka deklaruar se i ka kuptuar , ndërsa mbrojtjen do te jap vet, lidhur me aktakuzën me te cilën është ngritur procedura penale ndaj meje ,

Gjatë shqyrtimit fillestar te dt. 17.10.2017 ku është lexuar aktakuza nga ana e Prokurorit te shtetit dhe pas leximit te aktakuzës , I pandehuri T.R ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për veprën penale për te cilat akuzohet duke shtuar se e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit te aktakuzës ,

Në shqyrtimin fillestar dhe publik gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit te palëve , ka mare aktvendim me te cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë , nga se ka konstatuar se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë .Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri , se pranimi i fajësisë mbështet ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza dhe aktakuza, nuk përmban asnjë shkelje te qart ligjor ose gabime faktike . Pas deklarimit të të pandehurit për pranimin e fajësisë është mare edhe mendimi i Prokurorit te shtetit i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, nga se pranimi i fajësisë është bërë ne mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje ne provat te cilat janë bashkangjitur aktakuzës dhe te cilat gjinden ne shkresat e lëndës, jam ne dijeni se edhe me palën e dëmtuar jam pajtuar dhe ky pranim i fajësisë te merret si rrethana veçanërisht lehtësuese , po ashtu te merret si rrethanë lehtësuese bashkëpunim i vazhdueshëm I te pandehurit ne organet e drejtësisë ,

Gjendja faktike e vërtetuar .

Andaj duke u bazuar ne këto qe u cekën me lart gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- Se I pandehuri T R nga pa kujdesia e ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 9 par 1 dhe 3 te KPRK-së, , në kohën , vendin , dhe mënyrën e përshkruar si ne diapozitivin e këtij aktgjykimi , dhe atë me faktet e afuar me deklarimin e te pandehurit ne polici dhe Prokurori me ekspertizën e komunikacionit me përshkrimin e vendit te ngjarjes dhe raporteve policor , dhe raporteve mjekësore ,si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ne seancën e shqyrtimit fillestar

Tiparet qenësore (figura e veprës penale)

-Me neni 378 par 9 të KPRK-së , është para shikuar se formën themelore te veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 9 te KPRK-së , e kryen gj do kush i cili është pjesëmarrës ne trafikun publik , dhe se veprimet me te cilën kryhet kjo vepër penale janë të shumta dhe te llojllojshme , dhe kjo vepër kryhet me anë të drejtimit të mjetit me shpejtësi me të madhe se sa që është e lejuar , me parakalim jo te rregullte me lëvizje jot ë rregullte , me drejtim te mjetit ne gjendje jot e rregullte teknike , me drejtim ne gjendje te dehur apo drejtuesi kur është I lodhur , si dhe me veprimet te tjera te parapara me ligjin për sigurinë në komunikacion rrugor , e për te cilën është parashikuar dënimi me burgim prej 1 vitit deri ne 8 vjet. Ndërsa duke u bazuar në nenin 42, par 1 dhe nenit 71 par 1 të Ligjit për sigurinë e komunikacionit rrugor është parashikuar se shoferi i cili ne rruge synon te beje ndonjë veprim me mjetin (lëvizjen e mjetit ne anën e djathte ose te majte , te nderoj shiritin e komunikacionit , te tejkaloj , anashkaloj dhe veprimet tjera te ngajshme ) i lejohej te filloj një manovrim te tille nëse me pare është i bindur se mund te beje një gjë te tille duke mos rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit tjetër ne komunikacion ose pasurin duke u kujdesur ne këtë rast për pozitën e mjetit dhe për drejtim dhe

shpejtësinë e lëvizjes ,kurse me nenin 71 para 1 tejkalimi dhe anashkalimi lejohet kur ekziston dukshmëria adekvate dhe haps ir e mjaftueshme qe te beje veprimin e tejkalimit pa penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit tjetër ne komunikacion rrugor , .

- Vendimi për shpalljen fajtor

-Duke u bazuar ne këto qe u cekën me lart gjykata ka vendosur që te pandehurin T R ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale , rrezikimi I trafikut publik nga neni 378 par 9 e lidhur me par 1 dhe 3 te KPRK-së , nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për te njëjtën është edhe penalisht përgjegjës ,

Rrethanat që janë mare për baze me rastin e shqiptimit të dënimit .

Duke u bazuar ne neni 73 dhe 74 te KPRK-së me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit gjykata ka mare për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit . Ne veçanti me rastin e shqiptimit te dënimit është mare për bazë për veç rrethanave te shënuara me poshtë , edhe faktin se i pandehuri dhe familjaret e të dëmtuarës janë pajtuar ne mes veti ,moshën e shtyer te te pandehurit ,i pandehuri është i moshës 72 vjeçare , bashkëpunim i vazhdueshme i te pandehurit me organet e drejtësisë , përveç kësaj si rrethana lehtësuese për te pandehurin gjykata e ka mare pranimin e fajësisë nga i pandehuri , dhe se i pandehuri qe nga momentin kur ka ndodhur rasti –ngjarja nuk e ka vënë ne dilemë ngjarjen e ndodhur por për kundra zi gjithnjë ka shpreh keqardhje për atë qka ka ndodhe ,sjelljen korrekte te te pandehurit gjatë shqyrtimit fillestar, është ndier i përgjegjshëm për veprimet e tije , dhe ka shprehe keqardhje për veprën që e ka kryer, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale se me pare nuk ka qene i dënuar për asnjë vepër tjetër penale, si dhe premtimi i tij se ne te ardhmen nuk do te kryej ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethana renduse ndaj te pandehurit .

Sipas bindjes se gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj te pandehurit T R , duke mare për baze rrethana e përmendura me lart , është dënim i drejt e ne harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallen e përgjegjësisë se te pandehurit , si dhe me intezitetin e rrezikimit te vlere te mbrojtura te shoqërisë . Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen , do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me neni 41 te PPK-së.

Te pandehurit konform nenit 47 të KPPK-së e me pëlqimin e tij dënimi i shqiptuar me burg ne kohëzgjatje prej 6 muajve i është zëvendësuar me dënim gjobe ,

Vendimi për shpenzime e procedurës penale u muar komfrom nenit 450 par.1 te KPPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta realizoj ne kontest civil u morr ne kuptim te nenit 463 par 1 dhe 2 te KPPRK-së,

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PEJË ,DEPERTAMENTI I PERGJITHSHËM  
P.nr 329/16

Sekretarja juridike

---

Lindmire Begolli

Gjyqtari Gjykues

---

Ahmet Rexhaj

**KËSHILLË JURDIKE**

Kunder këtij aktgjykimi palët kane te drejt te parashtroj  
Ankësë në afat prej 15 ditësh ,nga dita e marrjes .Ankesa i dërgohet  
Gjykatës së Apelit në Prishtine ,përmes kësaj Gjykate.

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .

**APROVOHET** propozimi i të pandehurit për heqje dorë nga kërkesa për hudhje të akuzës dhe kundërshtimit të provave, konform nenit 249 dhe 250 të KPP-së

**ANULOHET** shqyrtimi i dytë dhe të gjitha provat e paraqitura nga prokurori të merren ligjërisht të pranueshme dhe gjykata nuk ka gjetur asnjë arsye ligjore për hudhje të aktakuzës konform nenit 250 të KPP-së

**CAKTOHET** shqyrtimi gjyqësor me dt. 11.4.2017, në orën 10:00, palëve prezent iu komunikua verbalisht kjo do tu shërbejë si ftesë në mënyrë të rregullt, ndërsa të dëmtuarit dhe dëshmitarit, ftesa do ti dërgohet në mënyrë të rregullt.

Shqyrtimi fillestar përfundoi në orën 13:50.

Palët prezent e nënshkruajnë procesverbalin pa vërejtje.

Prokurori i shtetit

I pandehuri

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Vë r t e t o j n ë

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r i,